

# Njoftim vendimi

Postuar në : 13/12/2023



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga Sokol Çomo kryesues, Ina Rama relatores, Mimoza Tasi, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz anëtare, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 20/2023, datë 19.05.2023, që i përket ankimit të Komisioneres Publike kundër vendimit nr. 634, datë 10.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Naim Tota.

Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 634, datë 10.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Naim Tota.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 13.12.2023.